



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice-Departamenti për
Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.26/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbardimore në lëndët përmbardimore, P.nr.129/2022 dhe P.nr.130/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Burbuqe Spahija-Kërveshi, pala ankuese, të cilën e përfaqëson në praninë e përfaqësuesit të palës ankuese, përmbarduesit privat, me datë 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Organi përmbardues - Përmbarduesi Privat, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në, është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkallim i autorizimit, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 1,000.00 euro (njëmijë), të cilën detyrohet t'a paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, nën kërcënimin e përmbardimit.

A r s y e t i m

Pala ankuese me datën 24.08.2022, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbardimin Privat ndaj përmbarduesit privat, duke pretenduar se i njëjti me ndërmarrjen e veprimeve përmbardimore lidhur me lëndët përmbardimore P.nr.129/2022 dhe P.nr.130/2022, ka kryer shkelje të dispozitave të LPP-së, duke i tejkalluar autorizimet e tij të përcaktuara me ligj. Sipas palës ankuese, përmbarduesi ka bërë bllokimin e llogarive të palës ankuese lidhur me shpenzimet e përmbardimit edhe palët që ishin në

procedurë ishin pajtuar që rastin t'a zgjidhin me marrëveshje me debitorin, pasi në këtë procedurë, pala ankuese e kishte bërë pagesën e borxhit ndaj kreditorit duke i propozuar komisionit që të shqiptohet masa disiplinore ndaj përmbauesit privat.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterët dhe Përmbauesit Privat, me datën 29.08.2022, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbauesit privat, si organ përmbaues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbauesi privat në lëndët përmbauese P.nr.129/2022 dhe P.nr.130/2022, me propozim që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë rast.

Përmbauesi privat, në përgjigjen e tij me shkrim dhe në seancën dëgjimore, ka theksuar se është e vërtetë se debitori-pala ankuese e ka paguar borxhin ndaj kreditorit me datën 24.06.2022 dhe për pasojë përmbauesi privat i ka realizuar shpenzimet përmbauese në përputhje me urdhrin për përmbauesit. Më tutje përmbauesi privat ka theksuar se debitori-pala ankuese në këtë rast është i obliguar që t'i paguajë borxhin me kamatë dhe shpenzimet e procedurës përmbauese. Poashtu përmbauesi ka shtuar se gjykata kur është fjala sipas prapësimit, nuk ka çka të vendos, meqenëse është paguar borxhi nga debitori, por vetëm të konstatoi lidhur me borxhin, pa e paragjykuar vendimin e gjykatës, ku gjykatën e ka njoftuar me një shënim zyrtar. I ka propozuar Komisionit Disiplinor që të refuzohet ankesa.

Komisioni Disiplinor pasi me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese vlerësoi çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim se përmbauesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se përmbauesi privat në këtë rast i ka tejkaluar autorizimet e tij me rastin e caktimit të përmbauesit-blokuar të llogarisë bankare të debitorit-palës ankuese vetëm për pjesën e cila ka të bëjë me shpenzimet e procedurës përmbauese, meqenëse borxhi i cili ishte objekt lëndor i çështjes, është paguar nga ana e debitorit. Me këtë rast komisioni vlerëson se përmbauesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, nën paragrafi 1 i LPP-së, ngase i ka bllokuar llogarinë bankare debitorit-palës ankuese, edhe pse lënda ende nuk është vendosur nga gjykata sipas prapësimit të debitorit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin e peshës së dëmit të shkaktuar ndaj palës ankuese, e cila ka ndikuar në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës

së përgjegjësishë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret e në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve përmbarimore të përmbaruesit privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor gjatë ofrimit të shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, edhe është qëllimi i masës. Ndërsa, detyrimi se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 368, paragrafi 3 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se gjobat në të holla, paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 26/2022 datë 23.09.2022



Kryesuesja e Komisionit disiplinor
Manushë Karaçi

Manushë Karaçi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374, par 5 të LPP-së.